KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit, Mars 2024

15.05.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit për muajin Mars 2024.

Rritet numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) në Mars 2024, krahasuar me Mars 2023

Në muajin Mars 2024, numri i fluturimeve të realizuara ishte 896 ose 24,1 % më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 286 932 ose 29,7 % më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Mars 2023).

Numri i fluturimeve Mars 2023 – Mars 2024



Numri i fluturimeve dhe udhëtarëve Mars 2023 – Mars 2024

Përshkrimi	03.2023	03.2024	03.2024 / 03.2023
Numri i fluturimeve të realizuara	722	896	24,1
Numri i udhëtareve në total	221 282	286 932	29,7

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Transporti Hekurudhor

Në muajin Mars 2024 numri i udhëtarëve ishte 5 790 apo 8,8 % më pak së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar.

Telefonia Fikse

Në muajin Mars 2024, numri i përdoruesve të rrjetit telefonik fiks ishte 68 459 apo 1,5 % më shumë së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte 2 921 663 apo 4,2 % më pak së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar (Mars 2023).

Përdoruesit dhe trafiku i realizuar në telefoninë fikse

Përshkrimi	03.2023	03.2024	03.2024 / 03.2023
Numri i përdoruesve te rrjetit telefonik fiks	67 466	68 459	1,5
Trafiku i realizuar (në minuta)	3 049 207	2 921 663	-4,2

Telefonia Mobile

Në muajin Mars 2024 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 502 518 apo 0,7 % më shumë së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 298 412 apo 7,8 % më shumë së në periudhën e njëjte të vitit të kaluar.

Përdoruesit e telefonisë mobile

Përshkrimi	03.2023	03.2024	03.2024 / 03.2023
Përdoruesit me parapagim (Prepaid)	1 491 817	1 502 518	0,7
Përdoruesit me kontratë (Postpaid)	276 769	298 412	7,8

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave të Transportit dhe Telekomunikimit për muajin Mars 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Transportation